



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 80 dt.30.04.1996

Këshilli Bashkiak i Qytetit Tiranë, i mbledhur sot me dt.30.04.1996, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Zyra Administratës për nevojat që ka Bashkia Tiranë për 6(gjashtë) shoferë shtesë për të përballuar detyrat e saj, mbështetur në Ligjin Nr.7906, dt.04.04.1995 “Për Buxhetin e Shtetit” dhe të V.K.M. Nr.673, dt.29.11.1995 “Mbi përdorimin e të ardhurave nga Pushteti Lokal”, pika.2/c për destinacionin e përdorimit të tyre,

VENDOSI

1. Të miratojë kërkesën për të shtuar 6(gjashtë) shoferë shtesë për përballimin e nevojave të Bashkisë Tiranë.
2. Të çelet fondi i nevojshëm për përballimin e pagës së shoferëve shtesë nga të ardhurat e Bashkisë për shumën mujore 55.092 lekë, duke filuar nga data 01.03.1996.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra Administratës, Zyra e Personelit, Drejtoria Administrimit Financiar dhe Zyra e Llogarisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA